



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 364/1 Prot

Tiranë, më 05/4 /2016

**Lënda:** *Jepet mendim mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*

**Drejtuar:** **Z. Saimir TAHIRI**  
**MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME**

Tiranë

I nderuar z. Ministër,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 846/11 prot, datë.15.03.2016, për dhënie mendimi mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", konstatohet parashikimi se mbledhja e të dhënave do të realizohet duke u kryer përpunimi i tyre në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ligji nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, kërkon që kontrolluesi të përcaktojë qëllimin e mbledhjes së të dhënave në aktet ligjore apo nënligjore që i përkasin organizimit, funksionit dhe veprimtarisë së tij/kontrolluesit.

Në këndvështrimin e mësipërm, projektligji vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Besnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**